



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.NR. *060-1643/18*
KLINË, 31.1.2018

PROCESVERBALI

I SEANCËS SË I-rë TË RREGULT TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 31.1.2018, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNËS

Në mbledhje prezantuan: Prof. Dr. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës, Besim Hoti, nënkryetar i Komunës, anëtarët e KK (27), drejtorët e drejtorive, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, Policia e Kosovës, zv.komandanti, Engjëll Prenaj, KFOR-i, OSBE, OJQ-të, mediet, qytetarë etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Fadil Gashi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të parën të rregullt dhe të parën për këtë vit të KK-së.

Fadil Gashi: “Një njoftim që keni marrë pardje, është anuluar vizita e kryeministrit, Ramush Haradinaj, për shkak të seancës së Kuvendit, gjegjësisht zhvillimeve në Kuvend, sigurisht që në një të ardhme tjetër do ta kemi Kryeministrin dhe sigurisht do të organizohemi njëjtë. Njoftimi i dytë, është kërkesë prej Shërbimit të Kuvendit, prej anëtarëve të Kuvendit, veç Enver Berisha, është mirë për ta konfirmuar edhe një herë adresën elektronike, sepse e kanë pasur problem për të komunikuar me adresën elektronike, përndryshe besoj se tek të tjerët është në rregull. Eventualisht nëse keni ndonjë defekt ose mungesë të marrjeve të ftesave dhe materialit është mirë edhe një herë për të konfirmuar E-mail adresën. Pjesa tjetër, e atyre që janë, qofshin institucione publike në Klinë, përfaqësues të tyre që marrin pjesë dhe ju dërgojmë ftesë dhe material, edhe një herë t’i përsërisin adresat në shërbim të kuvendit për hir të korrektësisë dhe të shpejtësisë për të dërguar materialet. Prej njoftimeve e kam edhe një, që dje më ka mbërritur një kërkesë, për t’i njoftuar anëtarët e KK-së, sigurisht, tash iu shpërndahet një regjistër, i jepni të dhënat tuaja, anëtarët e KK është fjala, për ueb faqen e Kuvendit nga një biografi dhe fotografi. Ajo fillon prej ditës së nesërme, prej datës 1 shkurt 2018, për të pasur qasje në ueb faqen e Komunës dhe anëtarët e Kuvendit të pasqyrohen aty me biografi të tyre”, ka pohuar kryesuesi Gashi, i cili në vijim vazhdoi:” Më lejoni që të kalojmë te rendi i ditës. Kur jemi te rendi i ditës unë kam një kërkesë për anëtarët e KK. Ne kemi marrë konfirmimin për zëvendësimin e dy anëtarëve të KK nga Komisioni qendror të zgjedhjeve, dhe kisha kërkuar mirëkuptim prej të gjithëve për ta aprovuar rendin e ditës, por pika e parë le të jetë dhënia e betimit të dy anëtarëve të rinj të Kuvendit, nëse pajtoheni për këtë ndryshim të rendit të ditës. Jam i detyruar për ta vënë në votim. Kush është për ndryshim të rendit të ditës?

Me vota unanime aprovohet ky ndryshim dhe pika e parë është dhënia e betimit të dy anëtarëve të KK. Prezent jemi 25 anëtarë derisa ta dhënë betimin edhe ata të dy, atëherë kuvendi do të jetë me numrin e caktuar të anëtarëve dhe bëhemi 27 anëtarë”, ka konstatuar kryesuesi Gashi, i cili kërkoi që të procedohet me këtë:

RENDI I DITËS

1. Dhënia e betimit të dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës,
2. Arsyetimi i mungesave,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i dy seancave të kaluara,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e shefave të grupeve kuvendare,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e KKSB,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komiteteve obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e komiteteve konsultative dhe themelimi i panelit intervistues:
 - Komiteti për Çështje Emergjente,
 - Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe mbrojtje të Mjedisit.

Pika e parë: Dhënia e betimit të dy anëtarëve të KK.

Kryesuesi Gashi, në vijim kërkoi që dy anëtarët e rinj të KK, Xhevxhet Berisha (VV) dhe Brahim Mehmetaj (Nisma), të dhënë betimin solemn.

Anëtarët e rinj të Kuvendit, Xhevxhet Berisha (VV) dhe Brahim Mehmetaj (Nisma) lexuan Deklaratën e betimit solemn.

Kryesuesi Gashi uroj dy anëtarëve të rinj sukses në këtë mandat.

Pika e dytë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se me plotësimin e Kuvendit me dy anëtarët e rinj, nuk ka mungesa të anëtarëve, janë gjithsej 27 anëtarë.

Pika tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbaleve të seancave të kaluara.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth dy procesverbaleve të seancave të kaluara. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim dy procesverbalet e seancave të kaluara.

Me vota unanime (27), u miratuan dy procesverbalet e seancave të kaluara.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e shefave të grupeve kuvendare.

Fadil Gashi, tha se ju e dini që në bazë të Statutit të Komunës, Rregullores të Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, caktohen fillimisht shefat e Grupeve kuvendare, njihen me këto dokumente zyrtare. “Unë fillimisht kisha kërkuar prej secilit grup që të propozojë ata që përfaqësojnë si grup kuvendar”, theksoi Kryesuesi.

U procedua me propozimet:

- Zeqir Morina – propozoi Enver Berishën (PDK)
- Enver Gashi – propozoi Violeta Zefin (LDK)
- Tunë Dedaj – propozoi Petrit Palushin (AAK),
- Xhevxhet Berisha – Në emër të GP të VV, NISMA - propozoi Saranda Elezajn

Fadil Gashi, theksoi se ju e dini që për të pasur një grup praktikë është të jenë tre anëtarë të Kuvendit dhe më shumë.
Kryesuesi uroi Shefat e grupeve kuvendare.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e KKSB.

Fadil Gashi, tha se sipas UA këtë këshill e udhëheq Kryetari i Komunës, përbëhet prej shumë kategorive dhe propozimet vijnë prej Zyrës së Kryetarit. “Në mungesë të Kryetarit këshillin e udhëheqë Nënkryetari i Komunës dhe në këtë rast, Kryetari ka bartur udhëheqjen e këtij këshilli, nënkryetari Besim Hoti. Ne në shërbim të Kuvendit i kemi marrë propozimet për këtë këshill. Ju e keni një material atje. I kemi marrë propozimet. Këshilli përbëhet prej përfaqësuesve të komuniteteve që jetojnë në Komunën e Klinës. Po i potencoj me radhë ashtu siç na kanë ardhur neve. Po i përsëris edhe një herë dhe pastaj na nevojitet një vendim formal”, shtoi Kryesuesi, i cili në vijim lexoi emrat e anëtarëve të propozuar;

1. Kryetari i Komunës – në këtë rast është nënkryetari i Komunës, Besim Hoti,
2. Komandanti i Stacionit të Policisë në Klinë, Rexhë Berisha,
3. Nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare në Komunën e Klinës. Në këtë rast BI ka deleguar emrin e Fitim Bojajt; famullitari i Kishës katolike në Klinë, dom Lorenc Sopi dhe Kisha ortodokse, Stefan Markoviq,
4. Nga një përfaqësues i secilit komunitet etnik në komunë. Te komuniteti serb neve na kanë ardhur dy propozime, është Rashi Ranko dhe Vinka Radosavleviq,
5. Te komuniteti ashkali kemi Mire Ramën,
6. Te komuniteti egjiptas, Azem Kerella dhe Ramadan Gashi,
7. Kryesuesi i Komitetit për komunitete,
8. Zyrtarja për Barazi Gjinore – Remzije Maloku,
9. Drejtori i DKA-së, z. Arben Limani,
10. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Klinës, z. Tunë Dedaj, është si përfaqësues i prindërve, jo i anëtarëve të Kuvendit,
11. Një përfaqësues i FSK-së, akoma nuk kemi marrë propozim, presim nëse na vjen propozimi plotësohet,
12. Një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike, edhe kjo pritet për t’u plotësuar,
13. Kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi, Hava Thaqi,
14. Një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile, komunale, - është Elmi Zenuni i propozuar,
15. Përfaqësuesi i Zyrës komunale për komunitete, Silvija Rashkoviq,
16. Një përfaqësues nga OJQ-ja – sot e kemi marrë një konfirmim, Florida Gashi,
17. Komuniteti i Biznesit, Prend Zefi,
18. Përfaq. i KFOR-it, Marko Maljevac,
19. Komuniteti për persona më aftësi të kufizuara nuk e kemi marrë akoma propozimin.

“Unë jam i detyruar për ta vënë në votim për ta marrë një vendim formal, vetëm mbetet pjesa e përfaqësuesve serbë le të mbetet një, i kemi dy propozime, le të merren vesh ata edhe pastaj i çojnë te kryetari, edhe plotësohet edhe me atë pjesë”, ka konstatuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se duke e pasur parasysh se katër vjet radhazi e kam udhëhequr KKSB, unë mendoj që është mirë në kuadër të kësaj përbërje që është propozuar nga Kryetari për t’u bërë

edhe një plotësim, duke e ditur rëndësinë e këtij këshilli dhe duke iu ofruar mundësinë të gjithëve që të jenë pjesë dhe angazhim, konkretisht në këtë këshill. “Unë, në bazë të këtyre prezantimeve që i bëtë po del se veç anës së pushtetit, pjesa e partive opozitare nuk është në kuadër të atij këshilli në asnjë përbërje. Mendoj që do të kishte për të qenë në interes edhe për këshillin, por edhe për krejt angazhimin tonë të përbashkët, që edhe në kuadër të kësaj përbërje për të pasur përfaqësues edhe nga opozita. Në një mënyrë apo një tjetër trajtohen tema që më të vërtetë janë me interes të gjerë, me interes të Komunës. Nëse partitë opozitare mbeten jashtë kësaj, atëherë kontributi ynë nuk po mbërrin ndoshta aty ku duhet, edhe është mirë ju ta shikoni këtë mundësi, që kërkesa jonë është për të qenë dikush edhe nga opozita në kuadër të këtij Këshilli Komunal për Siguri të Bashkësive”, theksoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se mbasi ti e ke udhëhequr, a keni pasur dikë të opozitës? “Unë kujtoj që ky është këshill që nuk ka të bëjë as me pozitë, as me opozitë. Të gjithë këta që i potencova vijnë sipas funksionit, sipas detyrës që kanë. Nëse nuk gaboju. Për mua nuk është pengesë që doni për të shtuar edhe si opozitë edhe të tjerë, mua nuk ma merr mendja që dikujt ia prishë vullnetin. Nëse doni për të plotësuar nuk prish asgjë fare. Le të ndiqet praktika qysh ka qenë”, pohoi Kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se unë mendoj që një pjese e madhe e njerëzve që përfaqësojnë qytetarin nuk janë në kuadër të atij këshilli. “Ai këshill është me interes për Komunën. Edhe nëse një pjesë kaq e madhe e përfaqësimit të qytetarit nuk është në kuadër të atij këshilli, për mua nuk është në rregull, ju prapë vlerësoni si të doni. Por, kërkesë jona është ne për të asistuar me prezencën tonë në kuadër të asaj përbërje”, theksoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se ti të na tregosh, a keni pasur përfaqësues të opozitës apo nuk keni pasur, ti vetë e ke udhëhequr. Nuk keni pasur askënd”, u shpreh Kryesuesi.

Enver Berisha, tha se kjo është çështje e Kryetarit, nëse Kryetari nuk e vlerëson që opozita nuk ka nevojë për të mos u përfshirë aty, ne jemi në rregull. “Nëse e sheh të nevojshme se ne duhet për të qenë në kuadër të asaj përbërje, le të urdhërojmë!”- shtoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se kërkoj që të jepet emri.

Enver Berisha, propozoi anëtaren Shqipnora Dautin.

Kryesuesi Gashi, vuri në votim listën me vërejtjet që të plotësohen ato që janë të zbrazët, të atyre institucioneve që akoma nuk i kanë deleguar përfaqësuesit e vet, edhe organizata “HENDIKOS”, dhe me këtë që u plotësua prej opozitës, kush jeni për?

Me vota unanime (27) miratohet lista e KKSBB me vërejtjet dhe propozimet tjera.

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për themelimin e komiteteve obligative:

- Komiteti për Politikë dhe Financa
- Komiteti për Komunitete

Fadil Gashi, tha se më lejoni fillimisht t’ju informoj, se angazhimi edhe i Kryetarit të Komunës, edhe i Nënkyetarit, edhe i drejtorit të Drejtorisë për Financa, edhe imi, si pjesë e tyre, jemi angazhuar dhe me kënaqësi ju njoftoj që të gjitha komitetet do të marrin kompensimin, karshi

vendimeve që ne ose ata që kanë qenë në mandatet të kaluara i dinë cilat vendime kemi marrë. “Do të respektohet Vendimi edhe i Qeverisë, edhe UA, dhe është dakordancë e plotë që të gjitha komitetet do të marrin kompensimin sipas këtyre dokumenteve të nxjerra, prej vendimit të Qeverisë, UA dhe Vendimit të Kuvendit që ky Kuvend e ka marrë atë vendim, duke u bazuar në ato dy të parat. Prandaj, kam lutje simpatike për të gjithë mos u fokusoni vetëm në dy komitete, sepse të gjitha do ta kenë kompensimin e njëjtë. Ju e dini sipas Statutit të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Punës së Komiteteve në Kuvend, ne i kemi gjithsej 9 komitete, 2 janë që i kërkon Udhëzimi Administrativ, 2 Komitete konsultative ose profesionale, 2 janë obligative, është KPF dhe Komiteti për Komunitete dhe 5 janë komitete tjera sipas fushave të përcaktuara, edhe të gjitha janë të sanksionuara edhe me Statut edhe me Rregullore të Punës së Kuvendit. Ne sot procedojmë me këto të dyja. Kisha pasur një lutje për gjithë shefat e GK, që tashmë janë të zgjedhur, deri në seancën e radhës për t’i prurë propozimet për komitetet e tjera, edhe në seancën e radhës ne për të marrë vendimin formal për plotësim. Te komitetet tjera, përpos këtyre dy obligative ndryshon numri i anëtarëve, numri është i sanksionuar, përpos këtyre dy obligative, që kanë nga 7 anëtarë, për komitetet tjera, të gjitha pa përjashtim, i kanë nga 5 anëtarë., pra numri është më i vogël, te këto dyja është numri çelës, veç është përcaktuar 7-shi dhe nuk mund ta ndryshojmë. Mund ta ndryshojmë nëse kenë vullnet për ta ndryshuar Statutin e Komunës, përndryshe nuk kemi mundësi. Prandaj, më lejoni që të fillojmë me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, çelësi është 7 anëtarë të Kuvendit, ne i kemi marrë edhe dokumentet tjera, udhëzimet tjera, kërkesat tjera, që jemi të obliguar për të pasur edhe përfaqësim gjinor. Duhet për të qenë përfaqësim gjinor i dinjitetshëm. Kisha kërkuar prej të gjitha grupeve që të jenë dorëlibër. Prandaj, jam i obliguar edhe në përgjigjet e mia në ato shkresa, sepse Kuvendi i Komunës së Klinës, po ta ketë vullnetin ashtu qysh e kërkojnë ata 50 me 50 për qind, ne nuk kemi mundësi, sepse vetë përbërja e Kuvendit ne kemi 30 për qind të përfaqësuar gjininë femërore. Ata nganjëherë dalin jashtë mundësive dhe realiteteve tona, mirëpo sido që të jetë unë e kam për obligim për ta respektuar këtë kriter dhe jo rastësisht po e them të jetë i dinjitetshëm përfaqësimi gjinor. Unë kisha propozuar, nuk do të thotë që është përfundimtar, ne hapim edhe debat. Prej 7 anëtarëve sa ka Komiteti për Politikë dhe Financa, unë kisha propozuar që Grupi Kuvendar i PDK-së t’i ketë 2 anëtarë, AAK 2, LDK 1, pa mua, unë vij sipas funksionit të Kryesuesit, edhe grupi tjetër veç po shohim se është themeluar me 3 dhe më shumë, 1 edhe bëhen 7 anëtarë. Unë po hap debatin. Unë propozova vetëm numrin, emrat ju mbesin juve”, theksoi kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, theksoi se besoj që ju jeni të vetëdijshëm se Qeveria, përkatësisht Ekzekutivi i Komunës me Asamblenë kanë dallim, kanë dallim për shkak se raporti i forcave është krejt ndryshe. “Është shumë e padrejtë dhe besoj e papranueshme, që një grup kuvendar me 10 asamblistë përfaqësohet me 2 përfaqësues në këtë komitet, ndërsa një grup tjetër me 5 anëtarë në KPF përfaqësohet prapë me 2 anëtarë! Domethënë, ne kërkojmë gjithsesi për të qenë më me shumë anëtarë që shkak të forcës dhe për shkak të prezencës që ka në Kuvend, ndërsa pjesën tjetër se si e ndani ju si pushtet është çështje juaja”, konstatoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se ne jemi mirë. “Nuk është jashtë realitetit, sepse sido që sillemi prapë numri i anëtarëve prej 14, gjegjësisht 15 është te ne, silluni nga të doni, ne prapë shumicë po mbetemi. Te pjesa tjetër nuk është fort e patrajtuar mirë, unë me 6 po e lë një pa e përfaqësuar. Kjo do të thotë se unë prapë jam më i dëmtuar”, shtoi Kryesuesi.

Kuvendar të PDK-së. Unë e vej në votim propozimin e parë me formulën që e dhashë: 2,2,2 dhe 1 të shkohet, nëse e voton Kuvendi”, tha Kryesuesi.

Kryesuesi e vuri në votim propozimin.

Me 15 vota për, pa kundër, pa abstenim, aprovohet propozimi i parë i Kryesuesit të Kuvendit: 2 PDK-ja, 2 AAK-ja, 1 LDK-ja, edhe 1 Grupi VV – NISMA.

Kërkoj prej gupeve ose shefave të tyre t’i dhënë emrat që të merren nga Shërbimi i Kuvendit.

Esat Raci – propozoi Enver Berishën dhe Zeqir Morinën (PDK)

Enver Gashi – propozoi – Violeta Zefin (LDK)

Petrit Palush – propozoi Tunë Dedajn dhe Valmir Bacajn (AAK)

Saranda Elezi – propozoi Avni Gashin (VV-NISMA-AKR)

Avni Gashi, theksoi se realisht e përkrah propozimin e zotit Enver Berisha, në këtë anën tjetër, edhe pse më propozoi kolegeja unë e falënderoj jashtëzakonisht shumë, por do të jem zë i opozitës edhe konstruktiv në KPF.

Fadil Gashi, tha se domethënë edhe tërhiqeni nga propozimi?

Saranda Elezaj, atëherë ne e tërheqim propozimin dhe e propozojmë anëtarin Xhevxhet Berishën për anëtar të KPF-së nga grupi ynë.

Gjokë Lleshi, tha se mendoj se ne duhet për të qenë më të përgjegjshëm, dhe është shprehja popullore ka thuhet: “Dita e mirë shihet në mëngjes”. Vërtet, u debatua dhe u diskutua shumë dhe në mënyrë të panevojshme, seriozisht ky mos seriozitet, që po më bën përshtypje jashtëzakonisht të këqija. Si mund në kohëzgjatje prej 10 sekondave të ndryshohen mendimet ose, ku është serioziteti i një përfaqësues i subjektit politik, të bëjë këtë, kur njeriu se vërtetë vetë u deklarua edhe pranoi atë formë. Kështu që, ndoshta është asambleja e parë që, vërtet, mund të bisedojmë diçka. Unë kam menduar që do të jemi pak më seriozë që na bën që të ecim përpara. Kisha kërkuar, që edhe përfaqësuesit, edhe propozuesit të jenë më në terezë, të mos i ndryshojmë për një minutë apo disa sekonda mendimet e tyre”, shtoi anëtarë Lleshi.

Fadil Gashi, theksoi se më të gjitha pajtohem, por te serioziteti Gjokë, është e drejtë e anëtarëve të Kuvendit, edhe unë ju kam premtuar një demokraci të mirëfilltë, për t’i dhënë hapësirë secilit. “Dhe, për të mësuar për seriozitetin, ne që dhjete vjet nuk kemi pasur seriozitet në këtë sallë. Edhe dhjetë duhet për të pritur. Ne kemi pasur vendime që janë kryer në mënyrë edhe me flagrante këtu, por unë po kam dëshirë për t’i shterë të gjitha mundësitë. Le t’i shterin njerëzit. Është e drejtë e anëtarëve të Kuvendit, edhe tash të LDK-së kanë mundësi për ta tërheq atë propozim, ne nuk e kemi vu në votim. Edhe një ta keni parasysh: nëse është te pagesa, me mirëkuptimin më të madh po e them, jo rastësisht, që në hyrje kam potencuar, në koordinim me Kryetarin dhe me pëlqim të ekzekutivit, të gjitha komitetet do të marrin kompensimin e nevojshëm. Ne këtë telashe më nuk e kemi, prandaj me qenë pak më të relaksuar, të shihet se nuk është vetëm një komitet, janë 9 komitete, bile s’kemi për të pasur mundësi, ne 27 anëtarë të Kuvendit jemi, anëtarët e KPF-së dhe të Komuniteteve, nuk kanë të drejtë në asnjë komitet tjetër të jenë anëtarë. Prandaj, ne duhet të marrim edhe nga jashtë për ta plotësuar pjesën tjetër. Prandaj, po them për ta parë pak më me sportivitet këtë çështje”, ka sqaruar kryesuesi Gashi.

Tunë Dedaj, tha se flas në emrin tim, me sa unë e kuptova Avniun. Avniu nuk u tërhoq prej propozimit, por tha “do të jem zë i fuqishëm i opozitës në Asamblenë Komunale”. Dua t’ju them ju të gjithëve, që unë do të jem zë i fuqishëm në Asamblenë Komunale atëherë kur do të vërej që drejtorët nuk janë duke punuar mirë. Mua mu duk që në atë aspekt e tha anëtari Gashi. Ai nuk u tërhoq, dhe ju kisha lutur ta vëni propozimin në votim dhe të kryhet”, shtoi anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, tha se për këtë pajtohem me ty, se ka raste kur ti je bërë me këta, ashtu ke votuar, këtë konstatim nuk pate nevojë ta deklaroni.

Saranda Elezaj, tha se si GP kërkojmë pauzë 10 minuta, për një konsultim.

Kryesuesi deklaroi pauzën prej 10 minuta.

Fadil Gashi, sqaroi se do ta bëjmë kalendarin e takimeve, mirëpo pa i themeluar komitetet nuk kemi mundësi ta bëjmë kalendarin. “Do t’i themelojmë komitetet edhe do të përshtatemi me kalendarin e tyre”, edhe po që se e zgjatemi nuk ka asgjë të keqe, sot është ditë e seancës, ditë e jona, s’ka asgjë të keqe”, shtoi Kryesuesi, i cili në vazhdim kërkoi 10 minuta pauzë.

Pas 10 minutave pauzë u procedua me vazhdimin e seancës.

Fadil Gashi: “Edhe një kërkesë: Unë qysh në start e di që vendimin kanë për të na kthyer, për shkak të kuotës së gjinisë. Po kërkoj mirëkuptim prej Kuvendit nëse keni hapësirë, tash jo pse LDK-ja ka propozuar vetëm Violeten, por kemi shkresa prej shumë institucioneve për ta plotësuar si kriter. Edhe kam për obligim për t’ju paralajmëruar se vendimi nëse shkon me të vetmen femër, Violeta Zefin, dijeni që ka për t’u na u kthyer vendimi. Unë nuk kam mundësi për ta imponuar vendimin e seancës, por e kam obligim për ta sqaruar. Kemi marrë shkresa, kemi marrë kërkesa, jemi të obliguar të paktën 30 përqindëshin”, ka sqaruar Kryesuesi.

Saranda Elezaj, tha se si grup parlamentar vazhdojmë me propozimin e dhënë për anëtar të KPF-së, dhe propozojmë Avni Gashi, me rotacion, vitin e parë, 2 vite VV edhe 1 vit NISMA. “Për çështjen viteve merremi vesh pastaj, por vetëm vitin e parë e ka AKR-ja, z. Avni Gashin” theksoi anëtarja Elezaj.

Fadil Gashi, tha se ju e vendosni vetë rotacionin qysh e bëni, është e lejueshme, është e praktikueshme në të kaluarën për t’u bërë. “Unë po e vej në votim me atë paralajmërim që ka për t’u na u kthyer, prapë do të vijmë në situatë të njëjtën, që kemi për ta zëvendësuar me gjini. Nëse s’ka mirëkuptim për momentin unë po e hedh në votim me shpresë se në seancën e radhës, eventualisht kur të na kthehet konfirmimi i ligjshmërisë, ne do të jemi të detyruar prapë për t’i hyrë kësaj kuote”, theksoi kryesuesi.

Violeta Zefi, theksoi se nuk po e kam të qartë, pse gjithë ky hezitim për të rekomanduar përfaqësim të gjinisë femërore në këto organe që edhe ashtu obligojnë. “Kur vjen puna për numër: 1,2,3 etj., për të dërguar në këtë komitet, kur është fjala për femra, për gra po hezitoni, Jam shumë e bindur se kemi për t’ju përfaqësuar bindshëm në këtë komitet. Kështu që, bëni ndonjë ndryshim, sepse është për të mirën tuaj!”- pohoi anëtarja Zefi.
Kryesuesi vuri në miratim listën e propozimeve për anëtarë të KPF-së.

Me 26 vota për, 1 abstenim u miratua kjo përbërje e KPF-së:

1. Fadil Gashi – Kryesuesi i KPF-së
2. Enver Berisha (PDK)- anëtar
3. Zeqir Morina (PDK)- anëtar
4. Violeta Zefi (LDK) – anëtare
5. Tunë Dedaj (AAK) – anëtar
6. Valmir Bacaq (AAK) – anëtar
7. Avni Gashi (AKR) – anëtar

- Themelimi i Komitetit për Komunitete

Fadil Gashi, tha se ju e dini se edhe kjo në bazë të LVL, Statutit dhe Rregullores të Punës së Kuvendit janë 3 anëtarë të Kuvendit dhe 4 anëtarë tjerë, që përfaqësojnë grupet etnike pakicë që jetojnë në Komunën e Klinës. Secili grup etnik propozon nga një. Edhe këtu kemi një dyfishim të emrave, të komuniteti serb. Ne kemi marrë shkresa për përfaqësim të grupeve etnike, të tjerat janë në rregull, pos te grupi etnik serb, të cilët kanë sjellë më shumë propozime. Këtu kemi nga një, 1 i komunitetit serb, 1 egjiptas, 1 ashkali dhe 1 rom. Të tjerat mendoj që i kemi mirë, mirëpo mendoj përpos te këta ose kemi mundësi si të doni ju si seancë ne mund vëmë cilindo që fiton, varianti i parë, i dyti është për t'u lënë hapësirë që të bisedohet edhe një herë me ata, edhe pastaj për t'u plotësuar me një emër, nëse ata mund të dakordohen, por s'mund të tejkalohet numri 7. Edhe kështu e thonë edhe ato dokumentet që unë i potencova, nja 1 përfaqësues. Ndërsa ne po procedojmë më nga 1 anëtar të Kuvendit. Edhe këtu kisha propozuar secili grup, PDK-1. LDK-1 dhe AAK-1. Po procedojmë me këta, pastaj unë po i them emrat që na kanë ardhur prej komuniteteve tjera, edhe në fund marrim vendim”, nënvizoi kryesuesi Gashi, i cili kërkoi që të procedohet me propozime.

Enver Berisha – propozoi Menduhie Duraku (PDK)

Petrit Palushi – propozoi Blerta Gashi

Violeta Zefi – propozoi Enver Gashi

Fadil Gashi, tha se më lejoni të prezantoj qysh i kam marrë propozimet.

Kryesuesi lexoi shkresat e të propozuarve të komunitetit serb: Në shkresën e Rranko Kostiqit, zyrtar në Zyrën komunale për kthim, propozon Sllavko Smigiq nga Dresniku.

“Në shkresën e dytë nga Vesna Peshiq, zv.përfaqësuese e bashkësisë serbe në Klinë, propozon z. Bozhidar Sharkoviq. Do të thotë janë dy propozime, që këtu duhet njëri. Ndërsa, për përfaqësim të anëtarëve të komunitetit ashkali dhe egjiptas janë propozuar, Sahit Balia dhe Mire Rama, ndërkaq nga komuniteti rom ka ardhur propozimi për Nexhmedin Gashin – Dollovë. Me këtë të tjerë jemi në rregull përpos të këtyre dy emrave të komunitetit serb ose të lihet hapësirë të merren vesh edhe një herë për t'ju dhënë mundësi, ne po plotësojmë këtë pjesën tjetër, nëse dakordoheni ju, pjesën tjetër ne po e aprovojmë, 3 anëtarë të Kuvendit, edhe 3 këta të tjerat-6, i 7-ti le të mbetet mes këtyre, le të merren vesh, ne pajtohemi për atë që ata pajtohen për të cilin merren vesh mes vete për përfaqësim”, ka shtuar Kryesuesi. Kryesuesi hapi debatin.

Petrit Palushi, tha se ne po pajtohemi që t'i lëmë ata që të merren vesh, pastaj nëse ata nuk e sjellin menjëherë propozimin ne vendosim njërin prej këtyre dyve.

Enver Berisha, theksoi se meqë është seanca e parë e rregullt, unë duke e ditur çështjen e seancave të ardhshme si do të veprojmë, në raport me pyetjet dhe kërkesat e GP, përkatësisht asamblistëve veç e veç. “A duam të merremi vesh që ato të jeni në fillim të seancës, para se të aprovohet rendi i ditës, apo në fund të seancës, me kusht që t’iu jepet mundësi drejtorëve që të jenë të gatshëm për t’u përgjigjur në seancën e radhës. Domethënë, është mirë të dakordohemi qysh sot”, theksoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, theksoi se e para, meqë ne tashmë i kemi shefat, besoj që kemi për të kaluar mirë me ta në konsultime, në përgatitje edhe të rendit të ditës, do të konsultohemi vazhdimisht. “Pyetje – përgjigje është obligative, është çështje ligjore, që duhet vendosur a doni në fund apo në fillim. Nëse kërkohet me dhënë mendim unë kisha thënë në fillim, po ajo le të mbetet vullnet i Kuvendit kur të donë, e vendosim për seancë e radhës dhe si të dëshironi vendosim”, theksoi Kryesuesi.

Tush Dedaj, tha se unë kam pritur të marr Rregulloren e Punës së Kuvendit me shkrim, ajo paska qenë me postë elektronike. “Unë kam menduar sot për ta kërkuar që neve që jemi të rinj në Kuvend të na jepet me shkrim nga një rregullore, pra do të kishte qenë në rregull ajo. E dyta, është te pjesa e procesverbalit, unë prita që ndokush do ta prezantojë ndonjë vërejtje, por askush nuk e bëri, për arsye se procesverbali nuk e pasqyron komplet rrjedhën e mbledhjes të seancës së kaluar. Ajo pjesa e votimit nuk është fare e përfshirë në procesverbal. Unë kam pritur që dikush do ta kërkojë atë, por si dokument do të kishte qenë për në rregull që të jetë në Arkivin e Kuvendit edhe të Shërbimit për Punë të Kuvendit”, ka konstatuar anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, tha se në fillim e thashë ne do të përgatisin ato dokumente dhe do t’ju shpërndajmë. “Dorën në zemër nuk është obligim yni, ju anëtarët e kuvendit mund të shkoni t’i merrni në shërbim të Kuvendit. Janë të gjitha, mirëpo ne kemi hasur në mirëkuptim me ua punuar anëtarëve të Kuvendit, edhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, edhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, nëse dëshironi ju edhe dokumente të tjera që këtu ka plot rregullore që ka miratuar kuvendi. Pjesa e procesverbalit ne veç e tejkaluam si pikë, ti pate mundësi të japësh vërejtjet, sepse ishte pikë e rendit të ditës. Kërkova, a ka kush rreth procesit, askush nuk pati vërejtje. Megjithatë, për ju që jeni për herë të parë, vlen për ta theksuar se procesverbali nuk përmban detajet e krejt seancës, e përmban thelbin e seancës, janë incizimet ato që janë në detaje, janë mënyrat tjera në të cilat do mund të keni qasje në gjithçka. Procesverbali, të gjithë e dini çka pasqyron, por nuk do të thotë për të mos pasur vërejtje. Mund të keni vërejtje, por është pikë e parë e rendit të ditës, në fillim e patëm. Edhe diçka për hir të procesit po e them: në seancën e kaluar nuk kemi pasur votim, ne kemi pasur betimin e një anëtari të Kuvendit, edhe njoftimin prej Kryetarit të Komunës për themelimin e ekzekutivit, domethënë nuk ka pasur votim”, ka sqaruar kryesuesi Gashi, i cili në fund falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë në këtë seancë të Kuvendit.

Kryesuesi seancën e konstatoi të përfunduar.
Seanca përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

